

VENDIM
Nr.741, datë 8.9.2010

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS KRYEVIDH TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kryevidh të qarkut të Tiranës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 113 (njëqind e trembëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 794 (shtatëqind e nëntëdhjetë e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kryevidh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kryevidh

Lidhja nr.1

NUMRAT RENDORË TË PRONAVE NË LISTËN E INVENTARIT	FUSHA E PËRDORIMIT TË PRONËS	LLOJI I TRANSFERIMIT
8-21	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE ARSIMORE.	NË PRONËSI
22-29	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E SHËNDETIT PUBLIK.	NË PRONËSI
31-40	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E STREHIMIT DHE MBROJTJES CIVILE.	NË PRONËSI
41-63	VARREZA PUBLIKE	NË PRONËSI
69,73,76,80,83,85,87,94, 98,99,112,113,114	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (KANALE TË TRETA DHE TOKA JOPRODUKTIVE).	NË PRONËSI
108-109-110-111	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA PRODUKTIVE).	NË PËRDORIM
115-580	INFRASTRUKTURË (SHESHE, RRUGË VENDORE, LULISHTE DHE SHËRBIME PUBLIKE)	NË PRONËSI
581-592	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E UJËSJELLËS-	NË PRONËSI

	KANALIZIMEVE.	
--	---------------	--